



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 3231 /2015

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40 , Udhëzimin Administrativ 2008/8 neni 6, Rregulloren për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatra, Vendbanime dhe Lagje Urbane neni 4, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 24.03.2016 merr:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLAVE LOKALE

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për emërimin e komisionit për koordinimin dhe zgjedhjen e këshillave lokale.

II

Komisioni përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve nga të cilët , 2 (dy) nga kuvendi i komunës (1 (një) i pozitës dhe 1 (një) i opozitës) , 1 (një) ekzekutivi i komunës, 1 (një) nga shoqëria civile dhe 1 (një) përfaqësues i fshatit , vendbanimit apo lagjes urbane.

III

Komisioni do të ketë këtë përbërje:

1. Qamush Brava
2. Bujar Ballazhi
3. Fari Kalisi
4. Burhan Vila
5. Përfaqësuesi i fshatit përkatës

IV

Nëpërmjet zyrës për informim të Komunës njofton qytetarët 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për tubimet e zgjedhjeve të këshillave lokale, me shpallje publike. Njoftimi duhet të përmbaj : rendin e ditës, datën , kohën dhe vendin e mbajtjes së tubimit.

V

Komisioni do të veproj në harmoni me rregulloren e kuvendit të komunës për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatra, Vendbanime dhe Lagje Urbane.

VI

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të kuvendit ndërsa do të ekzekutohet pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

VII

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Anëtarët e Komisionit, Drejtoria për Administratë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit
Data: 24.03.2016



Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 1860/2015

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40 , Udhëzimin Administrativ Nr.2008/10 për Organizimin dhe Funkcionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna neni 7.4, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit neni 57. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 24.03.2016 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË TRI KOMITETEVE KONSULTATIVE PËR VITIN 2015

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e punës së tri i Komiteteve Konsultative të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2015.

II

Duke ju referuar nenit I të këtij vendimi pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i punës për vitin 2015 i Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit, Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komitetit Konsultativ për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

III

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të kuvendit ndërsa do të ekzekutohet pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit, Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komitetit Konsultativ për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit
Data: 24.03.2016



Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 3230 /2016

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Doracaku Termat e Referencës për Komitetin për Komunitete neni 5.2, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit neni 57. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 24.03.2016 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2015

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2015.

II

Duke ju referuar nenit I të këtij vendimi pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i punës për vitin 2015 i Komitetit për Komunitete.

III

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të kuvendit ndërsa do të ekzekutohet pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Anëtarët e Komitetit për Komunitete, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 24.03.2016





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr.1279/2016

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12.2 shkronja (d), 40, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 24.03.2016 merr:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMUNALE PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA
2016-2019

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për strategjinë komunale për persona me aftësi të kufizuara 2016-2019.

II

Miratimi i këtij vendimi vjen pas propozimit të ekzekutivit të komunës dhe pas zhvillimit të gjithave procedurave ligjore. Strategjia Komunale e Personave me Aftësi të Kufizuara paraqet një plan për ta ndryshuar gjendjen e personave me aftësi të kufizuara, e cila përmban gjithsej 26 (njëzet e gjashtë) faqe dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të kuvendit ndërsa do të ekzekutohet pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Administratë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 24.03.2016





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr.1242/2016

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 neni 17 shkronja (f) dhe neni 40, Ligjit për mbeturina Nr.04/L-060 neni 8,10,15, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 6, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 24.03.2016 merr:

VENDIM PËR REVIDIMIN E PLANIT LOKAL TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE
2016 – 2020

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për revidimin e planit lokal të menaxhimit të mbeturinave 2016-2020.

II

Plani lokal i menaxhimit të mbeturinave 2016-2020 në komunën në Komunën e Hanit të Elezit i përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi është hartuar nga grupi punues i komunës së Hanit të Elezit dhe nga ekspertët e Demosit, i cili përmban gjithsej 35 (tridhjetë e pesë) faqe dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

Për zbatimin e këtij plani do të kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë Lokale.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të kuvendit ndërsa do të ekzekutohet pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

V

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë Lokale, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit
Data: 24.03.2016



**Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava**